



KËSHILLI DREJTUES

**V E N D I M**

**Nr. 09, datë 12.04.2018**

**“Mbi miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Procesit të Udhëheqjes në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për vitin 2017”**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja (j), të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe të nenit 14, pika 1 dhe të nenit 15, pika 4 të “Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 28, datë 3.11.2014, i ndryshuar, me propozim të Auditit të Brendshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

---

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Procesit të Udhëheqjes në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për vitin 2017, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**